

Dëshmia historike e një letre, dërguar nga Drenica

[Adem e Hamëz Jashari gjatë nisjes për në aksion](#) = [Adem e Hamëz Jashari](#)

ÇKA SHKRUAN ADEM JASHARI NË LETRËN - DËRGUAR LPK-së
NË DHJETOR 1997

Kjo letër, e dërguar nga Adem Jashari dhe e shkruar nga i vllai, Hamza, dhe e nënshkruar nga një grup luftëtarësh të Drenicës është njëri ndër mesazhet e luftës. Natyrisht, ajo nuk është shkruar me mendimin se do të botohet ndonjëherë; ajo është një letër mes shokëve të luftës, flet për realizimin e një aksioni dhe për probleme të tjera. Por, në gjithësecilin rrjesht të saj, tepër dukshëm, mund të shikosh atë që do të vinte më pas. E shkruar thjeshtë, si gjithçka që është madhërisht e bukur, pa fjalë të mëdha dhe pa mburrje, ajo mbart në vete dëshminë historike, jo vetëm të një beteje.

Kjo letër është shkruar në fundin e vitit 1997, më saktësisht në dhjetor të këtij viti. Fillimisht ajo është faksuar, nga jashtë Kosovës, sipas të dhënave nga një faks në aeroportin e Shkupit, e më pas ka ardhur edhe origjinali, pas disa ditësh, përmes kanaleve ilegale. Letra ruhet sot në arkivën e Lëvizjes Popullore të Kosovës, ku edhe është adresuar, ndërsa një kopje e saj ruhet në Kosovë.

Ja edhe letra, thuajse e plotë:

"Të dashur shokë e vëllezër,

Disa të dhëna rreth ngjarjes në fshatin Vojnik, të ndodhur me 25 nëntor 1997 në mes forcave tona dhe të policisë sekrete të okupatorit serb. Ngjarja fillon me lajmërimin e një automjeti civil të tipit "niva" me katër persona civilë, i cili bënte lëvizje të dyshimta në fshat, nga lagjja në lagje. Atë e vërejtëm dhe e përcollëm deri sa erdhi tek lagjja e Binakajve dhe pikërisht afër shtëpisë ku gjendet veprimtari ynë. Sipas rrëfimit të shokut, ky tentoi t'i identifikojë, por ata tentuan ta tradhetojnë duke u paraqitur njëri prej tyre se "jemi shqiptarë" dhe porsa ai e mbaron fjalën, njeri prej tyre shtien disa herë me revolver, në drejtim të veprimtarit tonë. Shkathtësia e tij e shpëtoi nga

plumbat dhe me shpejtësi të madhe ky ia kthen automatikun dhe e qëllon automjetin dhe dihet se i ka qëlluar disa nga të ndodhurit brenda. Të dyshimtit largohen me shpejtësi të madhe nga vendi i ngjarjes, duke lënë në vend shenjat e xhamave të thyer dhe shenja gjaku.

Kjo ka ndodhur rreth orës 14.00. Pasi largohen të dyshimtit, ky thehet në shtëpi dhe bashkohet edhe me tre shokët e tjerë, të cilët ishin të gatshëm për ndihmë, por rreziku mendohej se kaloi. Vendosën të mos largohen nga fshati se mos ndodh ndonjë intervenim i mundshëm policor. Ashtu edhe ndodhi.

Pas dy orësh, pra rreth orës 16.00, në fshat hyjnë dy autobllinda, të shoqëruar edhe nga një "NIVË" dhe mësyjnë lagjen e Binakajve. Këta, shokët tanë, zënë pozicionet në malin e afërt dhe në gardhiqet e afërta. Porsa mbërrim ekspedita ndëshkuese e forcave speciale, zbresin nga blindat dhe fillojnë të shtiejnë në drejtimesh të ndryshme, për të përhapur panik. Por, në atë kohë, forcat tona, të përbëra, si e thamë edhe më lart, nga katër persona, hapin zjarr dhe e kthejnë konfliktin mes tyre dhe ekspeditës ndëshkuese serbe. Të pabarabartë në numër e në teknikë, bëhet tërheqja në drejtim të pyllit. Forcat speciale serbe shtinin pa ndërprerje dhe filluan të afrohen, çka u detyruam të përdorim bombat, edhe pse të pakta. Atëherë, me përdorimin e bombave, serbët u tërhoqën në autobllinda dhe lufta bëhej vetëm nga autobllindat. Kjo zgjati deri rreth orës 18, por nuk mundën të na shtyejnë nga pozicioni që e zëmë në pyll. Kjo i shtyri të largohen me shpejtësi të madhe nga lagjja dhe fshati.

Nga ana jonë nuk patëm viktima ose të plagosur: Kurse nga ana e armikut ka patur shenja gjaku në vendin e ngjarjes, sidomos të shumta ishin ku janë përdorë bombat.

Sa i përket organizimit të mëvonshëm dhe informimit të antarëve, ngjarja zhvillohet kështu: Në organizimin tonë ekzistojnë edhe vëzhguesit e terrenit. Njëri prej tyre vëren autobllindat duke shkuar në drejtim të Klinës apo Turiqevcit, deri sa për rastin që biseduam më lart, kishim informata. Bëhet lajmërimi i disa prej punkteve tona dhe ata bënë lajmërimin e antarëve, por vetëm të jemi të gatshëm, që porsa të marrim lajmin se çfarë po ndodh në terren, të jemi të gatshëm për

ndihmë. Nata e bëri të veten dhe me vonesë u bë e ditur se ishte fshati Vojnik ku shkuan forcat policore. Edhe pse ne shpejtua drejt Vojnikut, tërheqja e policisë bëri që të mos konfrontohemi atë mbrëmje. U tubuam dhe konstatuam se nga forcat tona nuk kishte humbje. Vendosëm që të jemi në vëzhgim të terrenit, në të gjitha rrugët që të shpien drejt vendit të ngjarjes. Dërguam vëzhguesit, pra edhe të tjerët, vendosëm, pasi e morëm edhe pëlqimin e shokut në ngjarje të drejtpërdrejtë që: nëse policia do të ndër marrë ndonjë operacion ndëshkues, të bëjmë rezistencë. U vendos që para mëngjezit të zihen pikat më strategjike në rrugët që shpien drejt rajonit të rrezikuar, duke e patur parasysh se forcat mund të ndërhyjnë nga Mitrovica, Peja, por edhe nga Prishtina. U caktuan grupet që do të zënë pritë, por edhe vëzhguesit për lajmërim. Çdo gjë në Drenicë dhe rreth saj ishte nën kontroll. Dëshira jonë ishte dhe lutëshim, që bash në vendin ku edhe ndodhi konfrontimi, të jetë ashtu.

Pra aty e parashikonim se do të kornim fitore. Kemi pasë mundësi edhe më heret, pra në vend tjetër t'i "shkurtojmë", por bash aty, ku edhe e dëshironim, na erdhën, ishim disa grupe, në disa pritë. Kolona ishte e gjatë. Kishim lajmin nga vëzhguesit se janë të shoqëruar edhe me helikopterë. I pritëm deri sa hynë në mesin e të gjithë grupeve nga 3 - 4 e deri në 5 veta në grup, ku numri i përgjithshëm nga ne ishte prej 23 vetash (kuptohet prej fshatit Lludevëq deri tek vendi i quajtur "kryqat e popit"). Të tjerët ishin në vende të tjera, për të mos i përshkruar tash të gjitha.

Kolona hyri ku dëshironim. Së pari sulmuam me minahedhës, e pastaj disa me bomba e disa me armë zjarri të ndryshme, si automatikë, snajperë e mitralozë. Konfrontimi filloi rreth orës 10 ku zgjati deri rreth orës 13 -14.

Operacioni ishte shumë i vështirë, luftë e ashpër, e pandërperë, harxhuam shumë municione, sidomos në helikopterët. Disponimi në forcat tona ishte në nivel, edhe pse disa ishin të parët, përveç harxhimeve në municion, nga forcat tona nuk pati humbje e as të plagosur. Çka është më e rëndësishmja, edhe fshatarët e këtyre anëve u përgjigjen dhe u mbushen malet me luftëtarë të gatshëm, ku gjatë tërheqjes policia u sulmua nga të gjitha anët, e ku policia në panik shtiu kah munda, në objekte civile, shkolla e xhami.

Pasi i shtymë të tërhiqen forcat speciale serbe shkuam në vendin e ngjarjes ku ishin forcat armike. Ata kishin lënë në vend shumë dëshmi që të tregojnë se kanë pasur humbje dhe se kanë qenë të hendikepuar nga paniku. Gjetëm municion të ndryshëm të kalibrit të madh e deri tek revolverët, veshje antiplumb të përgjakura, shlema, karikatorë të ndryshëm, maska kundër gazrave, patrona lotësjellës e shumë e shumë të tjera. E gjithë rruga që nga fshati Lludevijq e deri në vendin "Kryqat e popit" ishte e mbuluar nga gëzhonjat. Damet e pësuar nga armiku, çka na i kemi parë, janë një autobлинд i kallur, një i prishur, mitralozin e shkatërruar, njërin nga "pizgauerët" e djegur e disa blinde të damtuar pjesërisht. Helikopteri dyshojmë se ka qenë i goditur, se shumë shpejt u largua dhe më nuk u duk, duke i lënë forcat e veta të vetmuara, gjysëm ore para se të tërhiqeshin.

Kemi kërkesa të mëdha për antarsim, por mungon armatimi. Shumë pak keni punuar në këtë drejtim. Prandaj shokët që veprojnë në këtë trevë të Drenicës, kërkojnë që të përfaqsohemi me një nga shokët tonë të mëhershëm që tani e disa kohë gjendet jashtë, nën emrin e tij konspirativ "VESHI".

Në fund të këtij rrëfimi ju përshendesim përzemërisht nga Drenica.

Lavdi të rënve për liri.

Nga një grup shokësh,

Të nënshkruar:

Rafeta,
Gipa,
Zena,
Dili,
Nura,
Dyli,
Gafurri".

Kush janë të nënshkruarit e kush është "Veshi"

Një sqarim për lexuesit:

"Rafeta" - ishte pseudonimi i Adem Jasharit,

"Gipa" - ishte Iliaz Kodra (komandant i brigadës "Fehmi Lladrovci"-
vrrarë në luftë),

"Zena" - ishte Zenun Kodra,

"Dili" - ishte Fadil Kodra,

"Nura"- Nuredin Lushtaku,

"Dyli" - Hamëz Jashari,

"Gafurri" - Abedin Rexha, i njohur më vonë si "Sandakani", komandant
brigade, i vrarë në luftë.

Nga shtatë të nënshkruarit, katër janë vrarë në luftë, tre të tjerët
janë sot në TMK, me gradat superiore, gjeneral major e më tej.

Ndërsa "Veshi" ishte emri konspirativ i Ramiz Lladrovci - gjatë luftës
i caktuar me detyra të një rëndësie të veçantë pranë Lëvizjes
Popullore të Kosovës, si përfaqësues i saj në Shqipëri dhe pranë Shtabit
të Përgjithshëm të UÇK-së.

Jam mrekulluar gjithnjë prej kësaj letre, që kur e kam pasur në
duar për herë të parë, mrekullohem edhe tani. Përgjithsisht aksionet e
ndryshme të UÇK-së janë informuar në Shtabin e Përgjithshëm ose në
Kryesinë e Organizatës. Disa prej tyre ruhen ende. Por kjo letër, e
shkruar thjeshtë, nga njëherë duke i rënë shkurt disa ngjarjeve, ajo ka
në vete edhe një vlerë të madhe : Asnjëherë e askund nuk mund të
gjesh mburrje, rrahje gjoksi, askund nuk gjen emra të përveçëm, se
ishte ai apo isha unë, por gjithçka mbeti në emërin e shokëve dhe të
luftëtarëve të lirisë.

Rreth tre muaj pas kësaj letra Adem Jashari u vra në luftë. Mirëpo
kushdo që ka rastin të lexojë këto rradhë mund të kuptojë fare mirë se
asgjë nuk ka qenë e rastësishme. ([Bedri Islami](#) *)

08 Mars 2008 - pashtriku.org

Bedri Islami , ish - Kryetar i Lëvizjes Popullore të Kosovës.